



Raporti i Auditorit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

31 dhjetor 2016

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	3
Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit	4
Shënimet e pasqyrave financiare	5
Shtjoca 1 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit	17
Shtjoca 2 Numri i punonjësve	18

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.granthornton-ks.com

Për Auditorin e Përgjithshëm

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (më tej referuar si "Organizata" ose "ZKA"), që përfshinë Pasqyrën e Pranimi të Parave dhe Pagesave dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, Pasqyra e Pranimi të Parave dhe Pagesave dhe Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin që perfundoj më 31 dhjetor 2016, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga ZKA në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët Profesionalist (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të ZKA-së në Republikën e Kosovës dhe ne kemi përmbushur përgjegjësi të tjera etike në përputhje me Kodin e BSNEK-së. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03 L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 041/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116 të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme dhe për kontrollë të brendshme siç përcakton menaxhmenti, është e nevojshme të mundësojë përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e parimit të vijimësisë së ZKA-së, shpalosjet, zbatueshmërinë, çështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse menaxhmenti dëshiron të likuidojë ZKA-në, ndërprejë operacionet ose nuk ka alternative reale por ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiarë të ZKA-së.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë ofrimi i sigurisë së arsyeshme në lidhje me çështjen se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimit dhe lëshimi i një raporti të auditorit që përmbanë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojnë gabimet materiale nëse ato ekzistojnë. Gabimet mund të ndodhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo në tërësi pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve që bazohen në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtrimit, dizajnojmë dhe performojmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i moszbulimit të gabimeve materiale nga mashtrimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se risku i mashtrimit mund të përmbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollat e brendshme që janë relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinion mbi efektivitetin e kontrollave të brendshme të ZKA-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që ZKA-ja mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që ZKA-ja të ndërprejë së përbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësimin e prezentimit, strukturës dhe përmbajtjes së përgjithshme të pasqyrave financiare duke përfshirë shpalosjet dhe nëse pasqyrat financiare prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen, përpos çështjeve të tjerave, për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësitë e mëdha eventuale në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ky raport është përkthim jozyrtar i versionit original në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.


Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë

31 maj 2017

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

3

Shënime	2016		2015		2014	
	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK	Pagesat nga palët e treta	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK	Pagesat nga palët e treta	Llogaria e Vetme e Thesarit BKK	Pagesat nga palët e treta
	në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
BURIMET E FONDEVE						
Granti Qeveritar	2,194	-	2,140	-	2,112	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve	41	-	63	-	57	-
Gjithsej pranimet	2,235	-	2,203	-	2,169	-
SHFRYTËZIMI I FONDEVE						
Operacionet						
Paga dhe Mëditje	1,690	-	1,613	-	1,480	-
Mallra dhe Shërbime	507	-	564	-	644	-
Shërbime Komunale	25	-	26	-	27	-
	2,222	-	2,203	-	2,151	-
Transfere dhe Subvencione						
Shpenzime Kapitale	13	-	-	-	18	-
	13	-	-	-	18	-
Gjithsej pagesa	2,235	-	2,203	-	2,169	-

Pasqyrat financiare vjetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016 janë autorizuar për publikim nga Z. Besnik Osmani Auditor i Përgjithshëm dhe Z. Fatmir Uka Zyrtaari Kryesor Financiar, më 30 janar 2017.

Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

Fatmir Uka
Zyrtari Kryesor Financiar

Shënimet përcjellëse janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Pasqyra e Ekzekutimit të Buxhetit
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2016

4

Shënime	2016			2015		2014	
	Buxheti fillestar (Përvetësimi) A në euro 000'	Buxheti Final (Përvetësimi) B në euro 000'	Aktual C në euro 000'	Varianca D=C-B në euro 000'	Aktual E në euro 000'	Aktual F në euro 000'	
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
7 Donacione	-	64	64		90	18	
8 Të hyrat tjera	-	-	1		11	4	
Pranimet totale të mbledhura për BKK-në	-	64	65		101	22	
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e thesarit							
9 Paga dhe Méditje	1,674	1,704	1,690	(14)	1,613	1,480	
10 Mallra dhe shërbime	551	521	507	(14)	564	644	
11 Shërbime komunale	34	26	25	(1)	26	27	
12 Transfere dhe Subvencione Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	
Totali i pagesave i bërë nga BKK përmes LIVTh	2,309	2,264	2,235	(29)	2,203	2,169	

Shënimet përcjellëse janë pjesë përbërse e pasqyrave financiare

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

1 Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është themeluar në vitin 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18, të datës 4 tetor 2002. Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës mandati dhe roli i Auditorit të Përgjithshëm është specifikuar në Kushtetutën e vendit. Rregullorja e UNMIK-ut u zëvendësua me **Ligjin nr. 03/L-075** mbi Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, aprovuar me datë 05 Qershor 2008.

Sipas Kushtetutës (neni 138) Auditori i Përgjithshëm (AP) duhet të raportojë çdo vit mbi rezultatet e auditimit (Raporti Vjetor i Auditimit dhe raportet mbi detyrat individuale) dhe mbi aktivitetet e tij (Raporti Vjetor i Performancës).

Kuvendi i Kosovës më 18 maj 2016 ka miratuar Ligjin e ri nr. 05 / L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Më 10 qershor 2016 ky ligj u shpall në Gazetën Zyrtare dhe hyri në fuqi më 26 qershor 2016.

Ndryshimet më të rëndësishme në këtë ligj janë:

- 1) Emri i Institucionit është ndryshuar, "Zyra Kombëtare e Auditimit",
- 2) Ka ndryshuar statusi i një pjese të stafit, psh. bazuar në ligjin e ri - për stafin drejtues dhe stafin e auditimit nuk zbatohet Ligji mbi Shërbimin Civil.

2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit

2.1. Bazat e përgatitjes

Sipas ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë Nr. 03/L-048 dhe Ligjit Nr.04/L-194 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë paraprakisht përgatitë dhe dorezojë Pasqyra Vjetore Financiare në përputhshmëri me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombetare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") në përputhje me bazën e kontabilitetit me para te gatshme të amendamentuar nga Ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr.04/L-116 Auditorit Gjeneral i kerkohet të përgadisë pasqyrat financiare. Për më shume, këto pasqyra financiare përfshijnë shpalosjet të kerkuara nëpërmjet Rregullores Financiare Nr. 03/2013 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore.

Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk është shprehur ndryshe. Kërkesat shtesë janë zhvilluar gjatë viteve.

2.2. Konventa e Kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e parasë së gatshme të kontabilitetit. Sipas kësaj baze:

- a. Të hyrat njihen kur ato pranohen. Ato alokohen nga fondet në dispozicion në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK), sipas së cilës fondet e alokuara duhet të shpenzohen në kuader të ndarjeve të tilla dhe të njohura si "fondet e alokuara" për atë ndarje.
- b. Shpenzimet njihen kur paguhen nga llogaria bankare e BKK.
- c. Pasuritë jo monetare janë prezantuar për qëllime të shpalosjeve. Kostoja historike e këtyre pasurive paraqet koston e blerjes dhe çdo shpenzim shtesë i lidhur drejtpërsëdrejti me blerjen e këtyre pasurive.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit (vazhdim)

2.3. Valuta raportuese

Librat dhe shenimet e ZKA-së mbahen në Euro, valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

2.4. Prokurimi

Marrëveshjet kontraktuese për blerje apo marrje me qira të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë shërbimet profesionale, nënshkruhen, në emër të ZKA-së, vetëm nga zyrtaret e autorizuar. Aktivitetet për blerje apo marrje me qira, përveç nënshkrimit të kontratës, përfshijnë thirrjen për tendere, kuotime apo propozime me fumitorë të mundshëm mbi bazën e specifikimeve të detajuara siç përcaktohet në Ligjin nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

2.5. Zotimet

Zotimet, ashtu siç janë shpalosur në pasqyrat financiare, regjistrohen kur urdhërohet ndonjë blerje që ka të bëjë më vitin aktual buxhetor, edhe pse mallrat dhe shërbimet në to vertetë janë pranuar/dhënë, dhe detyrimi është shkaktuar në buxhetin e vitit të ardhshëm.

2.6. Data e Autorizimit

Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2016, janë autorizuar nga ana e z. Besnik Osmanit, Auditori i përgjithshëm dhe z. Fatmir Uka, zyrtar kryesor financiar me 30 Janar 2017.

2.7. Buxhetet

Buxheti final është i përfshirë në Sistemin Informatikë të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe gjithashtu është publikuar si pjesë e pasqyrave financiare të Qeverisë së Kosovës.

2.8. Shpalosja e pasurive

Pasuritë mbahen për të përdorur ose për qëllime administrative, dhe janë të paraqitura në notën e shpalosjes në vlerën e kostos minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga vjetërsimi, nëse ka. Kosto përmban çmimin e blerjes së pasurisë.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 1

Ndarjet e fondit të përgjithshëm

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2016	2015	2014
		BKK	BKK	BKK
		në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
Paga dhe mëditje		1,690	1,613	1,480
Mallra dhe shërbime		466	501	587
Shërbime komunale		25	26	27
Shpenzime kapitale		13	-	18
Gjithsej		2,194	2,140	2,112

Shënimi 2

Grantet e përcaktuara të donatorëve

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2016	2015	2014
		BKK	BKK	BKK
		në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
Mallra dhe Shërbime		41	63	57
Gjithsej	2.1	41	63	57

2.1 Në këtë shpenzim përfshihen:

a) Pagesa prej 31.460 Euro, donacion nga Zyra bashkpunuese Helvetas - Zvicëranë në Kosovë për projektin "Mbështetja e AP dhe ZKA për Përmirësimin Institucional" dhe;

b) pagesën prej 9,901 Euro, donacion nga Bashkimi Evropian për projektin "Mbështetja financiare e konferencës së tetë vjetore të ZKA-së".

Shënimi 3

Pagat dhe mëditjet

Përshkrimi	Shënime	2016	2015	2014
		BKK	BKK	BKK
		në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
Pagat neto		1,413	1,349	1,240
Tatimi mbi të hyrat personale		113	106	96
Kontributi pensional nga punëdhënësi		80	77	70
Kontributi pensional nga i punësuar		80	77	70
Pagesa për Sindikatë		4	4	4
Gjithsej		1,690	1,613	1,480

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 4
Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shënime	2016	2015	2014
		BKK në euro 000'	BKK në euro 000'	BKK në euro 000'
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	4.1	52	46	35
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	4.2	45	37	35
Interneti		2	1	1
Shpenzimet tjera telefonike /Z.mobile		16	21	22
Shpenzimet postare		-	1	1
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4.3	9	42	98
Shërbime intelektuale dhe këshilluese	4.4	18	75	66
Shërbime kontraktuale të tjera	4.5	48	33	22
Shërbime teknike		1	1	1
Shpenzimet për anëtarësim		-	-	2
Mobiljet dhe pajisjet(më pak se 1000)		4	2	9
Telefona (më pak se 1000€)		2	-	-
Kompjuterë (më pak se 1000€)	4.6	46	6	34
Hardwer për TI (më pak se 1000€)	4.7	11	6	-
Pajisje tjera (më pak se 1000€)		2	4	2
Furnizime për zyrë	4.8	10	16	5
Furnizime ushqim dhe pije		21	18	20
Furnizime pastrimi		-	-	-
Furnizime veshmbathje		-	1	-
Akomodimi	4.9	1	8	23
Vaj për ngrohje		12	11	8
Derivate për gjenerator		-	-	1
Karburant për vetura		4	6	8
Regjistrimi i automjeteve		1	-	1
Sigurimi i automjeteve		2	2	2
Taksa komunale		-	-	-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		11	11	14
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		6	6	9
Mirëmbajtja e objekteve	4.11	16	12	14
Mirëmbajtja e tekn.informative		12	12	10
Akomodimi	4.10	1	1	1
Qiraja për objekte	4.12	126	154	168
Qiraja-pajisje	4.13	17	20	24
Qiraja perdorime tjera të hapsirave		2	-	1
Reklammat dhe konkurset		1	1	1
Shërbime shtypje -jo marketing	4.14	6	9	5
Informimi publik		-	-	-
Drekat zyrtare		2	1	1
Gjithsej		507	564	644

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 4 (vazhdim)
Mallrat dhe shërbimet (vazhdim)

4.1 Këto shpenzime pasqyrojnë intensitetin më të lartë të ekipeve të auditimit në akomodimin në terren në hotele brenda Komunave të vendosura më shumë se 45 km nga Prishtina. Diferenca mes shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2015 lidhet me faktin se numri i auditimeve të performancës të kryera në komuna më shumë se 45 km nga Prishtina është rritur gjatë kësaj periudhe. Në planin e auditimit për sezonin 2016/2017 janë 6 komuna të tjera (që vetëm ishin kontraktuar në sezonin e auditimit 2015/2016) dhe 4 kompani publike që janë në procesin e auditimit nga stafi ynë. Ky fakt ka ndikim në rritjen e shpenzimeve për këtë kod buxhetor.

4.2 Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar është pjesë e portofolit tonë. Fondet e shpenzuara kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e stafit tonë në punëtori dhe konferenca jashtë vendit (seminare në Sarajevë, Luksemburg, Holandë, Mal të Zi, Latvia, Shkup dhe Suedi). Në këto shpenzime janë përfshirë edhe shpenzimet për auditimin e dy misioneve diplomatike të Kosovës në Zvicër dhe për pjesëmarrjen e ZKF në konferencën INTOSAI në Emiratet e Bashkuara Arabe. Pjesëmarrja e stafit tonë në projektin e auditimit paralel me Zyrat Kombëtare të Auditimit të vendeve fqinje pati një ndikim të rëndësishëm në rritjen e shpenzimeve brenda vitit 2016 krahasuar me vitin paraprak. Shuma prej 2,720 euro nga donacioni i Zvicrës - Demos janë të lidhur me punëtorinë në Shkodër, ku tema e diskutimit ishte finalizimi i planit të auditimit për këtë vit dhe fillimi me sezonin e auditimit për 2016/2017.

4.3 Kjo shumë prezanton shpenzimet për pagesën e provimeve dhe anëtarësisë vjetore për stafin auditor. Shpenzimet më të ulëta në vitin 2016 krahasuar me dy vitet paraprake janë për arsye se auditorët e rregullsisë vitin e kaluar i kanë përfunduar ligjëratat e skemës publike të çertifikimit, deri sa skema çertifikuese për auditorët e performancës ende nuk ka filluar të implementohet.

4.4 Kjo shumë prezanton shpenzimet e bëra kompanisë private të auditimit – “Grant Thornton”, e kontraktuar për auditimin e PVF -2015 të 6 Komunave të Republikës së Kosovës si dhe kompanisë private të auditimit- “Deloitte Kosova”, e kontraktuar për auditimin e PVF-2015 të Ministrisë dhe Administratës dhe Pushtetit Lokal. Diferenca e shpenzimeve krahasuar me vitin e kaluar është si rezultat i përfundimit në këtë vit të disa projekteve të cilat janë financuar nga donatorët tanë. Auditimi i ndërmjetëm i të gjitha komunave të Kosovës gjatë sezonit të auditimit 2016/2017 është kryer nga ekipet tona audituese, pa pasur nevojë të kontraktohen nga jashtë.

4.5 Shpenzimet e rritura krahasuar me vitin 2015 janë si rezultat i angazhimit të dy këshilltarëve në projektin : "Në mbështetje të AP dhe ZKA për përmirësim të efikasitetit Institucionale" - të financuar nga Qeveria Zvicerane.

4.6 Kjo shumë paraqet shpenzimet për pajisje të stafit me pajisje të TI-së (70 llaptopë). Për shkak të rritjes së efikasitetit në punë është shfaqur nevoja për avansim të mjeteve të punës dhe është bërë pajisja e stafit me llaptop të ri.

4.7 Kjo shumë paraqet shpenzimin për blerjen e 70 monitorëve me performanca më të avancuara, për stafin auditues.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 4 (vazhdim)
Mallrat dhe shërbimet (vazhdim)

4.8 Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me material zyrtar dhe gazeta ditore. Brenda kësaj periudhe të raportimit është blerë sasi më e vogël e material zyrtar pasi që nevojat janë plotësuar nga stoqet 2015.

4.9 Kjo shumë prezanton shpenzimet të cilat ndërlidhen me organizimin e konferencës së tetë vjetore, shpenzimet e bufesë si dhe shpenzimet për furnizim me ujë të pijes. Këtë vit, shpenzimet për organizimin e konferencës së tetë vjetore janë mbuluar nga donacion i Bashkimit Evropian.

4.10 Nevojat për shpenzime në këtë kod gjatë vitit 2016 ishin shumë më të ulëta krahasuar me vitin paraprak.

4.11 Shpenzimet më të larta gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015 janë si rezultat i shpenzimeve të bëra për renovimin e hapësirave të zyrës, me qëllim të akomodimit më të përshtatshëm të personelit, sepse hapësira ekzistuese nuk i ploteson nevojat aktuale.

4.12 Shpenzimet e këtij viti janë më të ulëta krahasuar me vitin 2015 si rezultat i negocijimit dhe uljes së çmimit të qirasë mujore për të njëjtën ndërtesë.

4.13 Shpenzimet e këtij viti janë më të ulëta krahasuar me vitin 2015 për arsye të çmimeve më të ulëta të ofruara nga operatori ekonomik i kontraktuar për qiramarrje të pajisjeve fotokopjuese.

4.14 Si shkak i çmimeve më të ulëta të ofruara nga operatori ekonomik i kontraktuar për shtypje dhe lidhje të RVP dhe RVA - 2015, shpenzimet e vitit 2016 janë më të ulëta krahasuar me vitin 2015.

Shënimi 5
Shërbimet komunale

Përshkrimi	Shënime	2016	2015	2014
		BKK në euro 000'	BKK në euro 000'	BKK në euro 000'
Rryma	5.1	17	21	19
Uji		2	1	1
Mbeturinat		1	1	1
PTK-fikse	5.2	5	3	6
Gjithsej		25	26	27

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 Shënime për pasqyrat financiare
 Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 6

Shpenzime kapitale

	<u>Shënime</u>	<u>2016</u>	<u>2015</u>	<u>2014</u>
		BKK në euro 000'	BKK në euro 000'	BKK në euro 000'
Përshkrimi				
Blerja e serverëve		-	-	-
Softuer për intranet		-	-	3
Pajisje tjera (Skaner dhe fajlla metalik)		-	-	-
Softuer për dizajnim të raporteve		-	-	-
Softuer për menaxhimin e burimeve njerëzore		-	-	8
Softuer për regjistrim të kohës		-	-	7
Blerja e centrales se re telefonike	6.1	13	-	-
Gjithsej		13	-	18

6.1 Kjo shumë prezanton shpenzimin për furnizim me centralin e ri të telefonis fikse për 160 të punësuar në ZKA.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shënimi 7

Donacionet	Shënime	Emri i projektit	2016 në euro 000'
Emri i donatorit		Zhvillimi i aftësive profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit	12
Banka Botërore		Projekti "Në mbështetje financiare të konferencës së tetë vjetore të ZKA"	10
Unioni Europian		Projekti "Në mbështetje të AP dhe ZKA për permiresim të efikasitetit Institucionale"	42
Qeveria Zvicerane			64
Gjithsej:			

Shuma e planifikuar e donacioneve në vitin 2016 ishte 73,211 euro dhe është paraqitet si më poshtë:

- Donacioni në shumë prej 12,310 euro nga Banka Botërore. Kjo shumë u shpenzua në vitin 2015 dhe u rimbursua në vitin 2016.
- Donacioni prej 51,000 euro nga Helvetas- Zyra Bashkpunuese Zvicerane në Kosovë (nga të cilat vetëm 42,000 euro janë kërkuar dhe pranuar në vitin 2016) dhe
- Donacioni në shumë prej 9,901 euro nga Bashkimi Evropian.

Nga shuma e planifikuar, janë ekzekutuar 64,211 euro. Pjesa tjetër e donacionit nga Helvetas - Zyra e bashkpunuese Zvicerane në Kosovë në shumën prej 9,000 euro do të rregullohen në ndërkohë në mes të ZKA dhe Donatorit gjatë vitit 2017.

**Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016**

**Shënimi 8
Të hyra të tjera**

Shumat e mëposhtme paraqesin të hyrat e gjeneruara nga auditimet tona për fondet e donatorëve:

a) Pasi që OE "A&B Group", sh.p.k ka dështuar në realizimin e kontratës së nënshkruar me ZKA-në për mirëmbajtje të objektit tonë, të njejtës i është konfiskuar sigurimi i ekzekutimit të kontratës. Shuma 980 euro e konfiskuar me këtë rast prezantohet si e hyrë e ZKA-së gjatë vitit 2016.

Këto shuma të paraqitura më sipër janë të hyrat tona të regjistruara në Llogarinë Kryesore të Buxhetit të Kosovës dhe nuk janë përdorur nga ne.

**Shënimi 9
Paga dhe Mëditje**

Me Ligjin nr. 05/L-071, për buxhetin e Republikës së Kosovës, Institucionit tonë në fillim të vitit në këtë kategori ekonomike Paga dhe mëditje i është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 1,673,604 euro. Me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr 07/112 te datës 18 tetor 2016, Institucionit tonë në këtë kategori i aprovohet një ndarje shtesë e buxhetit në vlerë prej 30,000 euro.

**Shënimi 10
Mallra dhe Shërbime**

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-071, për buxhetin e Republikës së Kosovës, Institucionit tonë në fillim të vitit në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve i është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 551,289 euro. Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/123 të datës 28 dhjetor 2016, ndarja buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 85,473 euro në emër të kursimeve. Brenda vitit 2016 në këtë kategori ekonomike janë alokuar donacionet në vlerë prej 55,405 euro.

**Shënimi 11
Shërbime komunale**

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-071, Institucionit tonë në fillim të vitit në kategorinë e Shërbimeve komunale i është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 34,000 euro për buxhetin e Republikës së Kosovës. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/123 të datës 28 dhjetor 2016, kjo ndarje buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 8,293 euro në emër të kursimeve.

Shënimi 12

Me Ligjin nr. 05/L-071, për buxhetin e Republikës së Kosovës, Institucionit tonë në fillim të vitit në kategorinë e Shpenzimeve kapitale i është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 50,000 euro.

Me Ligjin nr. 05/L-106 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Institucionit tonë në këtë kategori i është shkurtuar ndarja buxhetore në vlerë prej 21,700 euro nga shuma e aprovuar me Ligjin e Buxhetit në fillim të vitit.

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.11/120 të datës 14 dhjetor 2016, kjo ndarje buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 15,319 euro në emër të kursimeve.

Shpalosja e detyrimeve (Neni 15)

Pasqyra e obligimeve të organizatës buxhetore

Përmbledhje					2016	
Data e faturës	Numri i faturës	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës	Shuma
30.12.2016	19854274	30 ditë	KEDS	Energjia elektrike	Këto fatura pasqyrojnë obligimet për shërbimet e dhëna nga furnitorët relevantë gjatë vitit 2016.	1,769
04.01.2017	Kooo18	30 ditë	MSS	Mirëmbajtja e ndërtesës		1,038
05.01.2017	2017/0007	30 ditë	Rrota	Mirëmbajtja e TI		80
04.01.2017	AH0005	30 ditë	Art House	Qiraja për fotokopje		380
19.01.2017	161101068 729/1727	30 ditë	Vala	Telefonia mobile		2,062
19.01.2017	18411729	30 ditë	Vala	Telefonia fikse		529
30.12.2016	F12836	30 ditë	Delta Security	Sigurimi i ndërtesës		949
31.12.2016	4309/16	30 ditë	Petroll Company	Naftë për vetura		247
04.01.2017	k00018	30 ditë	Pastrimi	Mbeturinat		257
13.01.2017	12/2016- zap	30 ditë	PK.SH.A	Shërbime postare		418
17.01.2017	fdt16-8- 005313	30 ditë	Hib Petrol	Naftë për vetura		373
12.01.2017	046/2017	30 ditë	Zyra e Kryeministrit	Gazeta zyrtare		26
16.12.2016	16-210- 001-1252	30 ditë	Zeri	Konkurs		60
05.12.2016	3896/16	30 ditë	Petrol Company	Derivate për vetura		816
12.12.2016	11/2016- Z.A.P	30 ditë	PK. SH.A	Shërbime postare		13
05.12.2016	161101068 729/1721	30 ditë	Vala	Telefonia mobile		2,079
23.12.2016	16008035	30 ditë	Restaurant Perla	Darka e fundvitit		2,420
Gjithsej						13,516

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Detyrimet kontingjente		2016	2015	2014
		BKK	BKK	BKK
Përshkrimi	Shënime	në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
Qiraja	15.1	10	10	10
Pagë	15.2	13	11	-
Përmbushje e kontratës	15.3	6	-	-
Totali		29	21	10

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë që mund të kërkohen nga pronari në bazë të padisë.

15.2. Shuma e prezantuar është një përlllogaritje e kompenzimit eventual për pagë.

15.3 Shuma e prezantuar paraqet vlerën e kontratës së nëshkruar për furnizim me material të zyrës.

Shpalosja e pasurive (Neni 16)

16.a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (mbi 1000€)

Klasifikimi i pasurive	Shënime	2016	2015	2014
		BKK	BKK	BKK
		në euro 000'	në euro 000'	në euro 000'
Veturat	16.1	15	-	-
Pajisje të TI-së		18	24	35
Pasuritë e tjera		3	4	7
Pasuritë fikse të paprekshme		9	12	27
Telefonia fikse	16.2	12	-	-
Gjithsej		57	40	69

16a.1 Kjo shumë paraqet vlerën e mbetur neto të vetures KIA Sportage, e cila është pranuar nga MMPH pas shkëmbimit të veturave mes ZKA-së dhe MMPH.

16a.2 Kjo shumë paraqet vlerë e blerjes së centrales së re te telefonisë fikse.

16.b) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (nën 1000€)

	Shënime	2016	2015	2014
		Vlera neto	Vlera Neto	Vlera neto
		në Euro 000'	në Euro 000'	në Euro 000'
Pasuria nën €1,000		106	76	97
Gjithsej	16b.1	106	76	97

16b.1 Blerjet e reja në vitin 2016, në këtë kod arrijnë vlerën 63,127 euro. Pjesa tjetër e ndryshimeve në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 në vlerën neto në libra paraqet vlerën e zhvlerësimit vjetor në shumën prej 32,578 euro.

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

16.c) Përmbledhje e stoqeve në fund të periudhës

<u>Shënime</u>	<u>2016 në euro 000'</u>	<u>2015 në euro 000'</u>	<u>2014 në euro 000'</u>
Klasifikimi i pasurive			
Material shpenzues	17	15	12
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator	7	1	4
Gjithsej	24	16	16

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shtojca 1

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale e buxhetit

Kategoria e ndarjes	Shënime	Përshtatjet e Autorizuara nga LMFPP						Ndryshime të buxhetit fillestar
		Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 29, Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenit 30, Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për burimet e tjera të financimit	Ndryshimet për grantet e përcaktuara të donatorëve	Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	
		A në euro 000'	B në euro 000'	C në euro 000'	E në euro 000'	në euro 000'	F në euro 000'	(f-a)/f në euro 000'
Hyrjet								
Donacionet	18.1	-	-	-	-	64	64	100.0%
Të hyra të tjera	18.2	-	-	-	1	-	-	100.0%
		-	-	-	1	64	64	100.0%
Daljet(buxheti)								
Pagat dhe mëdijet	18.3	1,674	30	-	-	-	1,704	1.8%
Mallrat dhe shërbimet	18.4	551	-	(85)	-	55	521	-5.5%
Shërbimet komunale	18.5	34	-	(8)	-	-	26	-24.4%
Transferet dhe subvencionet		-	-	-	-	-	-	0.0%
Shpenzimet Kapitale		50	(22)	(15)	-	-	13	-74%
Tjera		-	-	-	-	-	-	0.0%
Gjithsej		2,309	8	(109)	-	55	2,264	-2.0%

Shënime:

- 18.1. Shih shënimin shpjegues nr. 7
18.2. Shih shënimin shpjegues nr. 8
18.3. Shih shënimin shpjegues nr. 9
18.4. Shih shënimin shpjegues nr. 10
18.5. Shih shënimin shpjegues nr. 11

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

Shtojca 2

Numri i punëtorëve (Neni 19)

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 05/L-001	Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2016	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2016
GJITHSEJ	146*	150**	153***
Stafi(Auditorë& Mbështetës)	(118 & 28)	(122 & 28)	(125 & 28)

* Numri aktual i kufirit të punëtorëve është 146.

** Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2016 është 150, për shkak të faktit se katër (4) zëvendësues janë angazhuar si nëpunës civil të jo-karrierës për zëvendësim të stafit në pushim të lehonisë. Ky numër i punëtorëve nuk përfshin Auditorin e Përgjithshëm dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm. Auditori i Përgjithshëm përcaktohet të emërohet nga Kuvendi. Pozita e Drejtorit të Përgjithshëm rregullohet me ligjin e ri që është miratuar në Kuvend. Aktualisht ky post mbulohet përmes linjës buxhetore për Mallra dhe Shërbime për shkak të nevojës që kjo pozitë të jetë funksionale.

*** Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2016 ishte 153, duke përfshirë edhe katër (4) zëvendësues që janë pranuar për zëvendësim të stafit në pushim të lehonisë. Në këtë numër të punëtorëve nuk është i përfshirë Auditori i Përgjithshëm dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm.